

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **QENDRA E STUDENTEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208/90500-26-711-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me material higjenik për nevoja e Qendrës së Studentëve**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	N.T.SH. GIPA
NUI	600583323
Adresa	Rr. Luan Haradinaj p.n.
Vendi	Deçan
Kodi postar	51000
Numri Telefonit	+38349630900
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Milot Iberhysaj
Adresa elektronike	gipantsh@hotmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	03.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me material higjienik për nevoja e Qendrës së Studentëve

- **B05 Njoftim per Kontrat 17.03.2026**
- **B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara Dt:07.04.2026**
- **Afati i fundit për dorëzimin e ofertave sipas njoftimit për kontratë ka qenë**
- **28.04.2026 ne ore 13:30**
- **•Hapja e Ofertave të tenderit është bërë me dt. 28.04.2026, ora 13:30**
- **B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues me dt. 18.05.2026**
- **Krekës për qasje te dokumenteve Zyrtar me dt:18.05.2026**
- **Lejimi i kërkesës për qasjes me daten:19.05.2026**
- **Kerkes pe rishqyrtim 20.05.2026**
- **Vendim mbi kërkesën për rishqyrtim-25.05.2026**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjate kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kemi ber kerkes per rishqyrtim por AK e ka refuzuar edhe e ka kethyer si te pa

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 par.1 dhe 3 të ligjit nr.04/L-042 – Qëllimi.

Neni 7 par. 1 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042 - Barazia në Trajtim Jo Diskriminimi.

Neni 41 i Rregullave dhe UOPP-së - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Neni 51 të LPP nr 04/L-042 - Njoftimi i kriterëve të Përzgjedhjes.

Neni 52 Par 4 i LPP nr 04/L-042 - Njoftimi i Kriterëve për Dhënie të kontratës.

Neni 56 të LPP-së nr.04/L-042 - Dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe Dhënie të kontratave.

Neni 59 par.2 dhe 4 të ligjit nr.04/L-042 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tenderëve

Neni 60 par.2 i Ligjit nr 04/L-042 Kriteret për dhënie të Kontratës.

Neni 69 i LPP-së nr.04/L-042 - Aftësitë teknike dhe/ose profesionale.

Neni 72 i LPP-së nr.04/L-042 – Dokumentacioni dhe Informacioni shtesë.

Neni 27 pika 27.13,27.14 dhe 27.15 të RREGULLORES Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Operatori Ekonomik NTSH GIPA është OE i cili i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në FDT dhe konsiderojmë se jemi ofertuesi i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë kontrollit të dokumenteve, në të cilat na është lejuar qasja më datë 19.05.2026, kemi konstatuar disa shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik nga ana e Grupit të OE të shpallur fitues.

Gjetja e Parë:

Grupi i OE-ve “Sonat Group” SHPK dhe “Ananas Impex” SHPK kanë prezantuar listën e

kontratave për furnizimet e kryera, ku ndër to janë paraqitur kontrata të natyrave të ndryshme që nuk kanë të bëjnë me furnizime të natyrës higjienike, siç ka qenë kriter i përcaktuar në dosjen e tenderit.

Në rast të ofertimit si Grup i OE-ve, nga lideri i grupit kërkohet të plotësohet minimumi 60% e vlerës së kërkuar. OE “Sonat Group” SHPK, në cilësinë e liderit të grupit, ka prezantuar një referencë me një kompani private, mirëpo nuk ka bashkangjitur kontratën, procesverbalin e pranimit, faturën, fletëpagesat apo ndonjë dëshmi tjetër të qarkullimit bankar, siç kërkohet sipas LPP-së.

Po ashtu, edhe OE “Ananas Impex” SHPK, në cilësinë e partnerit, ka prezantuar kontratë me të njëjtën kompani private, pa bashkangjitur kontratën relevante, procesverbalin, faturën, fletëpagesat apo ndonjë dëshmi të qarkullimit bankar.

(Bashkangjitur: Prova 1)

Gjetja e Dytë:

Qendra e Studentëve i ka kërkuar Grupit të OE-ve sqarime lidhur me çmimet e dyshuara si jonormalisht të ulëta, ndërsa Grupi i OE-ve i është përgjigjur QS-së me një listë stoku, e cila nuk përmban asnjë përshkrim të detajuar të produkteve, faturë blerjeje apo ndonjë dëshmi të transaksioneve bankare për furnizimet e paraqitura.

Gjithashtu, Grupi i OE-ve ka paraqitur një ofertë nga OE “NTP GONI TRADE” me Nr. Fiskal: 600852695 dhe Nr. Biznesit: 70877082, ndërsa sipas të dhënave në ARBK rezulton se ky biznes është pasiv që nga data 09.06.2022. Për rrjedhojë, kjo dëshmi bie poshtë si e pavlefshme dhe e njëjta është dashur të verifikohet nga AK.

(Bashkangjitur: Prova 2)

Gjetja e Tretë:

Në paramasën e Grupit të OE-ve “Sonat Group” SHPK dhe “Ananas Impex” SHPK vërehet qartë se në shumë pozicione të artikujve esenciale të kërkuar nga QS janë paraqitur çmime të nënvlerësuara dhe dukshëm më të ulëta se çmimet reale të tregut.

Për këtë kemi prezantuar një tabelë në të cilën paraqiten qartë çmimet e furnizimit me shumicë nga prodhuesit. Në tabelë janë paraqitur artikujt me nr. rendor sipas paramasës: 2, 4, 8, 33, 38, 39, 58, 64, 72, 90 dhe 91, të cilët kanë rëndësi të lartë dhe për të cilët në paramasë është kërkuar specifikisht:

Verejtje: Detergjent për makina industriale të eneve, konvertomatave (furra elektrike me vet pastrim), kiperet, shamponet për pastrim me yndyra, për pastrim të kazanëve dhe të eneve, detegjenti i rrobave duhet patjeter të I përmbushin kriteret

e kerkuara sepse ketu kemi të bejmë meme yndyra, te sasisë së madhe dhe çdo detergjent nuk mund të kryej pastrimin siç duhet, andaj AK gezon të drejten e kthimit të ketyre produkteve deri në plotësimin e kërkesave të njesisë kerkuese.

Gjatë realizimit të kontratave të kaluara, NTSH GIPA, në cilësinë e kontraktuesit, është kërkuar në veçanti që të furnizojë produktet e lartcekura me cilësi të lartë, sipas kërkesave dhe vërejtjeve të përcaktuara në paramasë. Për këta artikuj kemi bashkangjitur faturat e blerjes, si dhe transferet bankare, me të cilat kemi furnizuar QS ndër vite.

Ndërsa Grupi i OE-ve i shpallur fitues nga AK ka paraqitur çmime jonormalisht të ulëta për produktet me nr. 2, 4, 8, 33, 38, 39, 58, 64, 72, 90 dhe 91. Sipas dëshmimeve dhe faturave të furnizimit që posedojmë, vlera reale e blerjes për këto produkte arrin në 87,115.00 €, ndërsa operatori ekonomik fitues i ka ofertuar në vlerë prej vetëm 54,800.00 €.

Nga kjo rezulton qartë se operatori ekonomik fitues paraqitet me diferencë negative/humbje në vlerë prej 32,315.00 €, çka ngrit dyshime të bazuara lidhur me qëndrueshmërinë dhe realizimin e kontrates.

(Bashkangjitur: Prova 3)

Gjatë kontrollit të dokumenteve, në të cilat na është lejuar qasja më datë 19.05.2026, kemi konstatuar disa shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik nga ana e OE TEKNIKA SHPK i shpallur si dyti i pergjegjshem.

Gjeta 1:

Në paramasën e OE TEKNIKA SHPK vërehet qartë se në shumë pozicione të artikujve esencialë të kërkuar nga QS janë paraqitur çmime të nënvlerësuara dhe dukshëm më të ulëta se çmimet reale të tregut.

Ne artikujt ne paramas me nr.rendor:1,8,38,39,58,72 qmimet e paraqitur ne OE TEKNIKA SHPK jane qmime jo normalisht te ulta dhe jane produkte te cekura ne paramas si produkte me verejtje qe ja te rendesis se veqant. Sipas dëshmimeve dhe faturave të furnizimit që posedojmë, vlera reale e blerjes për këto produkte arrin në 78,218.00 €, ndërsa operatori ekonomik TEKNIKA SHPK i ka ofertuar në vlerë prej vetëm 33,528.00 €.

Nga kjo rezulton qartë se operatori ekonomik TEKNIKA SHPK paraqitet me diferencë negative/humbje në vlerë prej 44,690.00 €, çka ngrit dyshime të bazuara lidhur me

qëndrueshmërinë dhe realizimin e kontrates ne rast se shpallet fitues.

(Bashkangjitur: Prova 1)

Ne, si Operator Ekonomik, pas kërkesës për qasje në dosjen e tenderit të parashtruar më datë 18.05.2026 dhe pas lejimit të qasjes në dokumentacionin zyrtar më datë 19.05.2026, gjatë shqyrtimit të dokumenteve të tenderit kemi konstatuar një numër të konsiderueshëm shkeljesh dhe parregullsish në procesin e vlerësimit të ofertave.

Për këtë arsye, më datë 20.05.2026 kemi paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, duke argumentuar në mënyrë të detajuar të gjitha shkeljet e evidentuara, përfshirë mangësitë në vlerësimin e dokumentacionit administrativ dhe teknik, si dhe pranimin e çmimeve të ofertuara të cilat, sipas fakteve dhe dëshmimeve të paraqitura nga ana jonë, paraqesin çmime jonormalisht të ulëta dhe të pamundshme për realizimin e kontratës.

Megjithatë, më datë 25.05.2026 Autoriteti Kontraktues ka nxjerrë vendim me të cilin kërkesa jonë për rishqyrtim është refuzuar si e pabazuar për kurder fakteve të paraqitura. Vlerësojmë se ky vendim është marrë në mënyrë të njëanshme, pa një analizë të plotë dhe profesionale të pretendimeve tona, pa trajtim të duhur të provave të paraqitura nga ne .
(Bashkangjitur: Vendimin e refuzimit nga AK)

Kërkoj nga Oshp-ja që ta shqyrtoj Ankesën tone dhe ta pranoj si të bazuar dhe kompaninë tone ta shpall si fitues të këtij aktivitetit të prokurimit dhe të ndryshoj vendimin për dhanje të kontratës dhe të shpërblej me kontratë Operatorin Ekonomik NTSh Gipa

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Kompania jonë si OE jemi të dëmtuarit në këtë tender-projekt, pasi konsiderojmë se nga AK janë bërë shkelje të dispozitave ligjore të LPP-së (të precizuara si më lartë)

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.

- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-së,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-së, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*